Forumi prezantoi metodën e ndjekur për hartimin me pjesëmarrje të Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit për Elbasanin dhe Fierin, me shtylla kryesore të saj Planin e Përgjithshëm Rregullues të Qytetit, Zhvillimin Ekonomik Lokal, Sistemin e Menaxhimit të Informacionit, si dhe Buxhetimin me Pjesëmarrje. Kjo paketë përbën modelin e instrumenteve të integruar me qëllim nxitjen e një qeverisjeje të mirë urbane, që Co-PLAN vijon ndërkohë ta zhvillojë më tej në përpunhje me filozofinë dhe misionin e organizatës.



Seminari rajonal Praktika të Qeverisjes së Mirë me Pjesëmarrje

Ballaqimi i praktikave dhe përvojave në fushën e Qeverisjes së Mirë me Pjesëmarrje midis përfaqësuesve nga vendet e Europës Lindore dhe Juglindore ishte fokusi i seminarit rajonal të organizuar nga 2-5 Tetor 2006, me mbështetjen e Fondacionit Soros. Seminari përvijoi në të njëjtën fryshtë me nisma të tillë për rajonin, si Deklarata e Vjenës 2004, Pakti i Stabilitetit, UN-Habitat, etj, duke ndikuar dhe lehtësuar bashkëpunimin në rajon.

Aktiviteti ishte një rast mjaft i mirë shkëmbimi përvojash e debati për 26 pjesëmarrësit, nga të cilët 12 ishin të ftuarit nga Rusia, Çekia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Hollanda dhe Kosova.

Kombimi i diskutimeve në plenare me vizitat në Bashkitë e Elbasanit dhe Fierit, dhe në zonën e Kënetës në Durrës, krijoj mundësi për të paraqitur nisma dhe arritje të njësive vendore për krijimin e Strategjisë të Zhvillimit të Qytetit, Planeve Rregulluese, proceseve të buxhetimit bashkiak me pjesëmarrje, etj. Në këtë mënyrë u nxit një klimë debati në nivel rajonal e ushqyer me argumenta konkretna, ku vëmendja e pjesëmarrësve u përqëndrua kryesisht tek aftësimi i pushteteve vendore (dhe partnerëve të tyre të shoqërisë civile) për t'u përballur me çështje të menaxhimit dhe mjedisit urban, strehimit, etj. Mesazhi që përcdoi seminari ishte ai i bashkëpunimit dhe nevojës së përhapjes të praktikave më të mira në rajon e më gjérë.





Çmimi Lidership për vitin 2006

Promovimi i vlerave më të spikatura të shoqërisë shqiptare bën pjesë në filozofinë bazë të organizatës. Në këtë këndvështrim, Çmimi "Lidershipi Shqiptar", i kthyer në një traditë tashmë që prej 3 vjetësh, synon të evidentojë individë me kontribut të vyer në zhvillimin e shoqërisë në fushën e shoqërisë civile, medias, biznesit dhe qeverisjes vendore.

Për vitin 2006 organizimi i çmimit të Lidershipit nisi që në muajin shtator me procesin e përzgjedhjes publike. U mirëpritën të gjitha propozimet e dërguara, mbi bazën e kritereve paraprake për dhënien e çmimit në katër fushat. Komiteti i Lidershipit Shqiptar për vitin 2006, pasi vlerësoi kandidaturat e propozuara, ndau çmimet në një ceremoni koktejli të organizuar me këtë rast në muajin dhjetor:

Znj. Eglantina Gjermenj, në kategorinë "Shoqëri Civile" për trajtimin e çështjeve të barazisë gjinore dhe zhvillimit të tyre në të gjitha shtresëzimet sociale.

Z. Arjan Çani, në kategorinë "Media", për emisionin "Zonë e Lirë", ku ka shtjelluar ide shpesh herë tabu për publikun shqiptar dhe ka pasqyruar njeriun me dinjitetin e tij të jashtëza konshëm para publikut.

Z. Ardian Turku dhe Z. Baftjar Zeqaj, përkatësisht kryetarë të bashkive Elbasan dhe Fier, në kategorinë "Qeverisje Vendore", për administrimin bashkëkohor të institucioneve që drejtojnë, duke ndërtuar modele qeverisje me pjesëmarrje.

Z. Refik Halili në kategorinë "Biznes", për kontributë financiare në zhvillimin kulturor e social të vlerave kryeqytetase, si rinovimi i urës së Tabakëve.

Aktiviteti i mbylljes së projektit mbi menaxhimin e mbeturinave të ngurta në Kamzë



Bashkia e Kamzës është një nga bashkitë që është asistuar nga Co-PLAN që nga viti 1998 me programe te ndryshme zhvillimi, nisur nga vetë karakteri i kësaj bashkie dhe problematikat urbane me të cilat është përbalitur. Projekti 3-vjeçar kishte për qëllim ngritjen e kapaciteve në fushën e menaxhimit urban dhe reformën institucionale për një menaxhim sa më efikas të bashkisë.

Projekti u mbyll me sukses me një seminar të organizuar me këtë rast në dhjetor 2006, ku edhe u prezantua libri mbi modelin e projektit. Të 40 pjesëmarrësit u njohën me veprimtarinë e projektit dhe mbështetën propozimin që bashkia të përvijojë punën në përputhje me Strategjinë e Menaxhimit të Mbeturinave, të haruar nga projekti, edhe për mandatin e ardhshëm elektoral.



Co-PLAN ishte ndër pjesëmarrësit e përzgjedhur në seminarin ndërkombëtar mbi Buxhetimin me Pjesëmarrje të financuar nga Banka Botërore. Seminar u zhvillua në Porto Alegre të Brazilit nga 5-10 qershori 2006 dhe pati perfaqësim nga rreth 40 vende nga Azia, Afrika dhe Europa. Ky aktivitet ishte një përvojë miaft frytëdhënëse përmes thelluar ekspertizën në proceset e buxhetimit publik me pjesëmarrje, e veçanërisht në lidhje me proceset e përfshirjes së komunitetit, ndërveprimit me politikat fiskale dhe menaxhimin finansiar, lidhjen me planifikimin urban, etj.

Pjesëmarrësit e Co-PLAN dhanë kontributin e tyre në seminar, duke paraqitur dhe shkëmbyer eksperiencën e Co-PLAN mbi buxhetimin me pjesëmarrje. Në kuadrin e projektit të financuar nga Banka Botërore dhe të zbatuar në bashkinë e Elbasanit, ky proces është trajtuar si mekanizmi finansiar në funksion të zbatimit të Strategjisë së Qytetit. Nën jehonën e këtij evenimenti ndërkombëtar, u organizua nga Co-PLAN tre muaj më vonë Seminari Rajonal mbi Qeverisjen e Mirë me Pjesëmarrje, ku temës së buxhetimit me pjesëmarrje lu kushtua një rëndësi e veçantë.

Forumi i 3-të Urban Botëror ishte një nga aktivitetet me të rëndësishme në rang botëror i organizuar nga UN-Habitat në qershori të 2006 në Vankuver të Kanadasë, ku Co-PLAN pati nderin të merrte pjesë si prezantues. Ky Forum kishte përmes kryesore "E Ardhmja jonë: Qytete të qëndrueshme – Të kthejmë idetë në veprime" dhe pati në qendër të vëmendjes një nga çështjet më të nxehta që ndesh sot globi: urbanizimin marramendës dhe ndikimin e tij mbi komunitetet, qytetet, ekonomitë kombëtare dhe politikat.

Duke përfaqësuar Shqipërinë midis 100 vendave dhe 10,000 pjesëmarrësve të tjera, Co-Plan kontribuoi me prezantimin e mbajtur në seminarin me temë "Forma e Qyteteve: Planifikim dhe Menaxhim Urban". Prezantimi, i cili u vlerësua miaft prej të pranishmëve, bëri një pasqyrim të situatës së krijuar si rrjedhojë e urbanizimit të menjëhershëm në Shqipëri, si edhe projektet dhe metodat e ndjekura nga Co-PLAN dhe institucionet shqiptare për të adresuar problemet dhe për t'i paraprirë zhvillimit të vendit.



Takimi i Paktit të Stabilitetit për ndërtimet informale

Kontributi i Co-PLAN në lidhje me çështjen e ndërtimeve informale u përfshi edhe në kuadrin e aktiviteteve të Paktit të Stabilitetit. Në 4-5 Maj të këtij viti u zhvillua në Durrës Takimi i Tretë Rajonal mbi Deklaratën e Vjenës, që është një dokument i rëndësishëm i nënshkruar nga vendet e rajonit në vitin 2004. Objektivat kryesore të takimit ishin: ndjekja e ecurisë së angazhimive konkrete të ndërmarrja dhe shkëmbimi i përvojave më të mira nga vendet nënshkruese të Deklaratës së Vjenës. Co-PLAN prezantoi me këtë rast projektet në Kamëz dhe Kënetë (Durrës), duke organizuar edhe një vizitë në terren me të ftuarit e takimit.

Pjesëmarrësit nga UN-HABITAT, CEB, EIB, UNDP, Bosnie-Herzegovina, Kroacia, Republika e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia dhe UNMIK/Kosovë, vlerësuan projektet në tërësi dhe diskutuan mbi parandalimin e ndërtimeve informale dhe të dukurisë së informalitetit. U theksua se këto raste të prezantuara, jo vetëm dëshmojnë përlarmishmërinë e fenomenit, por edhe përkompleksitetin e qasjeve për adresimin e problemit. Të pranishmit ndanë eksperiencat e vendeve të tyre dhe hapat e ndërmarrja nga qeveritë përkatëse në kuadrin e nismës së Deklaratës së Vjenës.

Vizitë pranë Institutit për Liri dhe Demokraci (ILD) në Peru

Gjatë vitit 2005 Co-PLAN i propozoi niveleve të politikës shqiptare një platformë për vendbanimet informale dhe informalizimin në përgjithësi. Kjo platformë u përvetësua dhe u përshtat nga qeveria e sotme për t'u bërë pjesë e programit të saj përvendin. Në kuadër të zbatimit të kësaj platforme, u realizua vizita e disa ekspertëve të qeverisë shqiptare, UNDP dhe Co-PLAN për shkëmbim eksperience pranë Institutit për Liri dhe Demokraci në Peru. Kjo vizitë kishte përqëllim koordinimin midis aktorëve kryesorë që do të bashkëpunojnë me ILD-në përzbatimin e programit mbi luftën kundër informalitetit. Gjithashtu, vizita i shërbeu ekspertëve të Co-PLAN të njohin më nga afër angazhimin e ILD-së në procesin kundër informalitetit në Peru dhe më gjërë.



Nga e majta në të djathië:

Sotir Dhamo, Orlana Arapi, Konalsi Gjoka, Floreta Aliaj, Anila Gjika, Jorik Haskaj, Rudina Toto, Eno Muho, Vezir Muharremaj, Jonida Cila, Enion Derra, Florjan Ravoniku, Oreola Caliqi, Dritan Shutina, Etleva Goxhaj, Darina Kokona, Manjola Duli, Dorina Nikolla, Jonida Sinani, Raimond Pengu, Amalia Tola.

Nuk përfshihen në këtë fotografji: Florjan Nuri, Indrit Faja dhe Redona Raça, të cilët janë larguar gjatë 2006 për të punuar në institucione të tjera.

KONTRIBUTE NDËR VITE

Co-PLAN nis i një projekt në një zonë informale në periferi të Tiranës. Në fillim ishte dëshira për të punuar me komunitetin dhe njerëzit e thjeshtë, me një filozofi të re të fryshtur nga konceptet perëndimore të demokracisë bazë. Kështu nis rrugëtimin e vet Co-PLAN, i ngjizur nga vëtëdija e nevojës për një këndvështrim të ri. Më pas, organizata do të ndërmerrte projekte të tjera me fokus zhvillimin e qëndrueshëm dhe qeverisjen e mirë në vend, duke marrë përsipër një mision plot sfida. Ndërkohë, Co-PLAN rritej si organizatë dhe jepte kontributin e vet në gjirin e shoqërisë civile. Mjafton të përmendim disa nga nismat e ndërmarra për të kuptuar vendin që zë organizata në mozaikun e përgjithshëm të aktorëve që nxisin zhvillimin në vend.

Së pari, vlen të veçojmë angazhimin e kahershëm të Co-PLAN në çështje të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të territorit, qeverisjes së mirë dhe decentralizimit. Ky angazhim është kurorëzuar tashmë me Platformën për reforma të përgjithshme në nivel kombëtar në çështje të Administrimit të Territorit dhe Qeverisjes. Kjo platformë, frysht i punës dhe angazhimit mëse dhjetëvjeçar, iu propozua të gjitha forcave politike dhe është pasqyruar tashmë në programin politik të qeverisë shqiptare.

Në vijimësi, degradimi urban dhe fenomeni i qyteteve-fjetore të pas viteve 90' u diagnostikua qartazi nga Co-PLAN, që nxiti energjinë qytetare për të planifikuar qytete të jetueshme të orientuara nga vizionii i së ardhmes. Me programe në mjaft bashki të vendit, apo zona informale, u synua krijimi i një sërë instrumentesh për një mirëqeverisje vendore. Me moton kryesore "Qytetet – Motorrë të Zhvillimit!" u synua të sigurohej themeli për një zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet strategjive afatgjata.



Më tej, organizata ka vepruar aktivisht në gjirin e shoqërisë civile, duke besuar në kulturën e bashkëpunimit dhe partneritetit me aktorë të tjera publikë apo privatë. Frysht i partneritetit me aktorë privat është edhe krijimi i Universitetit Polis, i cili është konceptuar në dobi të brumosjes së brezave me një perspektivë dhe konceptim të ri mbi arkitekturën dhe planifikimin urban.



Enton Derraj

Menaxher Projekti
Ekspert në Planifikim,
Urban
Nga 2001 në vitin



Salli Kelling

Eksperte mjedisi
2002-2004
Aktualisht jeton në Angli



Rajmond Pengu

Ekspert për Zhvillimin e
Kommunitetit, Menaxher
Projekti, 2001-2006




Edeva Goxhaj

Administratore
Financiare
Nga 2001 në vitin



Martin Heusinger

Ekspert për Turizmin,
Menaxher Projekti
2003-2005, Aktualisht
jeton në Gjermani



Enkelejda Ollodashi

Eksperte për Turizmin,
Menaxher Projekti
2003-2005, Aktualisht
jeton në Gjermani



Florian Nuri

Menaxher Projekti,
Ekspert në Zhvillimin
Ekonomik, 2003-2006
Pas 2006 Kordinator në
Kryeministri



Jorida Cila

Menaxhere Projekti,
Eksperte në Menaxhim
Urban dhe Çështje So-
ciale, Nga 2003 në vitin



Arta Kalavace

Ekspert na Planifikimi
Urban, Menaxher
Projekti, 2002-2004
Aktualisht sipërmarrës



Indrit Faja

Ekspert në Zhvillim
Ekonomik, Menaxher
Projekti, 2002-2006
Nga 2006 Ekspert në
Kryeministri



Oreola Caliqi

Eksperta Finance
Nga viti 2002 në vitin



Ilirjan Duka

Ekspert na Administrativ
Publik, 2003-2005
Aktualisht Kordinator
pranë PNUD



Vezir Muharremaj

Menaxher Projekti,
Eksperte për Pushtetin
Publik
Nga 2003 në vitin



Oriana Arapi

Menaxhere Projekti,
Eksperte për Pushtetin
Publik
Nga 2003 në vitin



Darina Kokona

Menaxhere Projekti,
Eksperte për Zhvillimin e
Kommunitetit
Nga 2004 në vitin



Gavrosh Zela

Menaxher Projekti, Ek-
spert Mjedisi Urban
2004-2005
Aktualisht konsulent



Anila Gjika

Menaxhere Projekti,
Eksperte Planifikimi
Urban/Infrastruktura
Nga 2005 në vijim



Jonida Sinani

Koordinatore Projekti,
Trajnuese
Nga 2005 në vijim



Konals Gjoka

Menaxhere Projekti,
Ekspert Mjedisi dhe
Energjete
Nga 2006 në vijim



Eno Muho

Planifikues Urban
Nga 2006 në vijim



Dorina Nikolla

Menaxhere Projekti,
Eksperte për Décentralizim
Nga 2006 në vijim



Florian Ravoniku

Planifikues Urban
Nga 2006 në vijim

Punonjësit e mësipërm janë angazhuar për një periudhë kohe mbi 1-vjeçare në Co-PLAN së bashku me Dorela Mansaku, Edvin Lame, Arta Karini, Kliti Mitra, Mirela Dalipaj, Suelia Muço, Valbona Spahija, Felicia Voli, Rosaria Cortellesa, Joke Matijsen, etj, fotot e të cilëve nuk ishte e mundur të paraqiteshin.

Ndërkohe, janë të shumtë punonjësit që kanë punuar pranë Co-PLAN për një periudhë kohe më pak se 1 vit, por kontributi i tyre është mjaft i çmuar për organizatën. Ndër ta përmendim: Redona Raça, Elida Metaj, Nevila Çomo, Elio Shala, Jorik Haskaj, Denis Leka, Elma Shehu, Elton Gjika, Elda Hoxha, Enkelejda Sotiri, Klaud Manehasa, etj.

PROFILI I ORGANIZATËS



Misioni dhe vlerat

Pas një veprimtarie në gjirin e shoqërisë civile të nisur që më 1995, organizata tashmë është konsoliduar dhe vijon në një stad të ri zhvillimi. Në mëse 11 vjet të ekzistencës së saj, organizata krijoj një eksperiencë pioniere në përputhje me misionin që kish marrë përsipër që në zanafilën e vet: nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe forcimin e shoqërisë civile. Gjatë vitit 2005 filloj për organizatën një proces ridimensionimi, i cili u diktua nga vetë dinamika e ngjarjeve dhe sfidat e kohës. Megjithë këtë proces të mbyllur në 2006, misioni i organizatës përvjoi në të njëtin kurs orientimi.

Misioni i Co-PLAN mbetet ai i një organizate joftimprurëse që kontribuon në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm urban dhe rajonal, duke mundësuar një qeverisje të mirë, zhvillimin e shoqërisë civile dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së komunitetit.

Si një qelizë mjaft aktive e shoqërisë civile, veprimtaria e Co-PLAN e ka burimin, në radhë të parë, tek misioni dhe vizioni i organizatës. Këto përbëjnë një udhërrëfyes të mirëfilltë për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të organizatës. Kultura dhe vlerat që ndahen nga anëtarët, të tillë si përkushtimi, profesionalizmi dhe përgjegjshmëria, janë guri i themelit të vazhdimësisë dhe ecjes përpara.

Zhvillimi dhe fushat e veprimtarisë së organizatës

Gjatë vitit 2006 u krye një ridimensionim i organizatës, që nënkuptoj në rradhë të parë reflektime në anën përbajtësore, si dhe në anën organizative. Ky riformatim i brendshëm i organizatës u kushtëzua nga disa faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët u identifikuuan gjatë periudhave të reflektimit të stafit dhe nga vlerësimi të kryera nga këshilltarë të jashtëm të Co-PLAN.


Faktorë të mjedisit të brendshëm: Kalimi i energjive njerëzore gjatë vitit 2005 për të kontribuar profesionalisht në nivele të qeverisjes qëndrore apo të institucioneve ndërkombëtare krijoj si rrjedhim një vakum, i cili ngrinte nevojën e riformatimit të brendshëm të organizatës. Këtu përmendim largimin e drejtorit ekzekutiv Besnik Aliaj (si këshilltar për çështjet urbane pranë Kryeministrat), e anëtarit të bordit ekzekutiv Flamur Kuçi (si këshilltar për çështjet urbane pranë Zv/Kryeministrat), e menaxherit të programit EGUG II Florian Nuri (si koordinator për ndihmën e huaj në Kryeministri), e koordinatorit të programit NET Ilirjan Duka (si koordinator në Sekretariatin Teknik të Donatorëve), e ekspertit Indrit Faja (si kordinatör në projektin për informalitetin pranë Kryeministrisë).

Faktorë të mjedisit të jashtëm: Në mjedisin e jashtëm, situata e zhvillimit social ekonomik të vendit ngriti sfida të mëtejshme në lidhje me rritjen cilësore të kontributit të ofruar nga organizata. Keshtu, u vu re ndryshimi i vazhdueshëm i "tregut" të produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga Co-PLAN. Për më tepër, mjaft agjensi të huaja donatore po zhvendosnin hapësirën gjeografike dhe fokusin e tyre tematik, duke sjellë si pasojë një ulje të paralajmëruar të fondeve për projekte zhvillimi në Shqipëri. Kjo shtroi para organizatës nevojën e mbajtjes së pozicionit të tanishëm, si organizatë zhvillimi me reputacion në shoqërinë civile. Nga ana tjetër, u pa nga donatorët tendencia e përkrahjes së rrjeteteve të konsoliduara të OJF-ve aktive ne gjirin e shoqërisë civile dhe projekteve me partneritete në fusha të qënësishme për zhvillimin e themelove të brishta të demokracisë shqiptare. Në ketë këndvështrim, një nga orientimet strategjike për organizatën ishte edhe forcimi partneritetevë në rrjetet ekzistuese, pa përjashtuar mundësitet për bashkëpunime të reja.

Nga ana përbajtësore u krye një rifokusim i veprimitarës në katër fusha kryesore, renditja e projekteve sipas këtyre fushave, si edhe përcaktimi më i mirë i shërbimeve që ofron Co-PLAN. Organizata ka strukturuar dhe përqendruar veprimitarinë që zhvillon në katër fusha kryesore tematike, që janë:

- 1 Menaxhimi Urban dhe Rajonal,
- 2 Menaxhimi Mjedisor Bashkiak,
- 3 Strehimi,
- 4 Zhvillimi Organizativ Institucional.

Të katër këto fusha harmonizohen dhe ndërthuren me rrafshin e forcimit të shoqërisë civile, i cili i përshkon të gjitha programet dhe projektet e organizatës. Ndërkohë, organizata jep shërbime që kategorizohen si asistencë teknike, trajnim, zhvillim institucional dhe kërkim shkencor.



Nga ana organizative, mënyra e fokusimit sipas këtyre katër fushave tematike të sipërpërmendura ka diktuar edhe një strukturë dinamike të mirëpërcaktuar, e cila ka njëkohësisht edhe standarde administrimi mjaft efikase. Këto standarde janë përcaktuar në Manualin e Procedurave të organizatës, të cilat u rishikuan gjatë vitit 2006 në përputhje me ridimensionim e organizatës. Pikë referimi për orientimin ndaj vlerave dhe etikës profesionale në veprimitarinë e organizatës është edhe Deklarata e Vlerave dhe Kodit të Etikës të Co-PLAN.

Struktura e organizatës

Guri themeli i zhvillimit të organizatës është vlerësimi që ndajnë mes tyre të gjithë pjesëtarët për partneritetin, transparencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo është edhe filozofia bazë e punës së rrëth 20 punonjësve të Co-PLAN, të angazhuar si ekspertë me kohë të plotë në një strukturë mjaft dinamike organizative. Kjo strukturë ka rrafshë vertikale, që sigurojnë cilësinë dhe standartet në menaxhim. Ndërkohë, mungesa e kompleksitetit i jep organizatës dinamizmin dhe e pëshmërinë e brendshme.

- Niveli më i lartë vendimmarrës është Bordi Drejtues, i cili orienton për strategjinë dhe politikat e organizatës. Bordi Ekzekutiv mban përgjegjësinë për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e veprimitarës së organizatës, sigurimin e fondevës dhe gjetjen e projekteve të reja, si dhe burimet njerëzore.
- Baza operuese janë ekspertët e angazhuar sipas projekteve, të cilët drejtohen nga menaxher projekti. Projektet grupohen sipas katër temave përkatëse, ku secila prej temave ka një menaxher tematik, i cili siguron cilësinë e projekteve ekzistuese nga ana përbajtësore dhe koordinon nisjen e projekteve të reja.
- Në njësitë administrative bëjnë pjesë: Departamenti i Financës dhe Byroja e Projekteve. Kjo e fundit është një njësi e ngritur rishtazi, ku përfshihet edhe administrimi dhe biblioteka. Byroja e Projekteve është konceptuar si siguruese dhe kordinuese e mbështetjes për projektet/programet. Veç kësaj, gjatë viti 2006 organizata aplikoi futjen e një sistemi të ri menaxhimi financiar GMSME. Kjo u realizua në kuadrin e mbështetjes organizative nga organizata hollandeze Cordaid nëpërmjet programit "Lehtësimi i Partneriteteve".

Monitorimi i ecurisë në nivel organizatë kryhet gjatë periudhave të reflektimit, kur ekspertët e Co-Plan diskutojnë mbi mbarëvajtjen e projekteve dhe standartet e menaxhimit. Këto periudha janë kthyer tashmë në një moment analize për të planifikuar aktivitetet e projekteve, si dhe për të siguruar sinergji, shkëmbim të ndërsjellë dhe vijueshmëri ndërmjet projekteve, duke ruajtur pikturën e përgjithshme të zhvillimit të organizatës. Gjithashtu, gjatë periudhave të analizës 6-mujore dhe vjetore, mund të kryhet sipas nevojës një vlerësim i përgjithshëm mbi organizatën dhe veprimitarinë e saj, bëhet planifikimi organizativ dhe strategjik për vitin apo 6-mujorin në vijim, në përputhje me misionin dhe objektivat e organizatës.

Bordi Drejtues



Bordi drejtues është një njësi vendimmarrëse në lidhje me politikat dhe strategjitë e përgjithshme të organizatës. Në të bëjnë pjesë:

Z. Sokol Çelo. Anëtar i Bordit Drejtues që nga viti 2002, ndërkohe që është këshilltar i jashtëm i Co-PLAN që prej 1999. Aktualisht po kryen studimet e doktoraturës në Florida, USA. Ekspert me përvojë në çështjet e zhvillimit organizativ dhe institucional, i certifikuar për moderim, trajnim dhe vlerësim projektesh. Gjatë karrierës së tij ka punuar si pedagog pranë Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Bujqësor, koordinator projektesh me GTZ (Kooperimi Teknik Gjerman), drejtues në nivel kombëtar i Projektit të PNUD në mbështetje të INSTAT, konsulent i jashtëm për organizata zhvillimi të huaja dhe vendase që operojnë në Shqipëri, etj. Është diplomuar për matematikë speciale në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, dhe ka kryer MBA në Tiranë.



Znj. Valdet Sala. Anëtare e Bordit Drejtues që nga viti 2002 dhe këshilltare e jashtme e Co-PLAN që prej 1999. Aktualisht është e angazhuar pranë GTZ-së si drejtuese programi. Në karrierën e saj profesionale ka punuar në poste drejtuese të rëndësishme, ku mund të përmendim: ish-sekretare në Komitetin Qendror të Rinisë, Drejtore e Bibliotekës Kombëtare Tiranë, Drejtore Programi në Fondacionin SOROS (Shoqëria e Hapur) për Shqipërinë, këshilltare për çështjet e shoqërisë civile dhe përkatësisë gjinore për Ballkanin Perëndimor, pranë European Foundation. Ajo është themeluese e Shoqatës "Refleksione" dhe një ndër aktivistet e para për çështjet e zhvillimit të gruas shqiptare, duke përfaqësuar lëvizjen e gruas në shumë konferenca kombëtare e ndërkombëtare. Në vitin 2005 iu akordua çmimi i Lidershipit Shqiptar për kontribut të shquar në gjirin e shoqërisë civile.



Z. Sef Slootweg. Anëtar i Bordit Drejtues që nga viti 2002, ndërkohe që gjatë 1995-2001 ka punuar në Shqipëri dhe është bashkëthemelues i Co-PLAN. Që prej vitit 1999 punon pranë SNV dhe aktualisht është këshilltar në Cotonou, Bénin. Ka themeluar Fondacionin "Crossover" më 1990, ku punoi deri më 1995 për shkëmbimin e përvojave në politikat e strehimit ndërmjet Evropës Lindore dhe asaj Perëndimore. Gjatë viteve 1985-1991 punoi si këshilltar për politikat e strehimit dhe ekonominë vendore pranë 'Workgroup 2000' dhe gjatë viteve 1991-1995 pranë studios 'RIGO Research & Advice BV' në Amsterdam. Ai ka qenë këshilltar për klientë si ministri, bashki, shoqatat e strehimit dhe organizatat e banorëve. Fushat e tij të interesit janë politikat novatore ekonomike vendore, rinovimi urban, strehimi social, pjesëmarrja qytetare, integrimi i emigrantëve, kujdesi për moshat e treta dhe procesi i tranzicionit në Evropën Lindore. Është themelues i një agjensie konsulencë dhe shërbimesh në fushën e politikave dhe praktikave urbane. Ka lindur në Holandë dhe ka studiuar gjeografi sociale dhe planifikim urban/rural në Universitetin e Nijmegenit.

Partneritete me rëndësi

Partneriteti është një nga vlerat më të spikatura që përbëjnë shtyllat e filozofisë së Co-PLAN. Organizata ka qenë nismëtare dhe pjesëmarrëse në mjaft partneritete apo rrjete bashkëpunimi, ku përmendim CDSnet (Rrjeti i Zhvillimit të Shoqërisë Civile për Qeverisjen me Pjesëmarrje në Ballkan), ENHR (European Network of Housing Research), apo programi NET, që ka kontribuar për shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e shoqërisë civile në vend apo rajon.

Gjatë vitit 2005 Co-PLAN u anëtarësua në rrjetin NOSA (Rrjeti i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë), i cili filloj të konkretizojë veprimtarinë e vet gjatë vitit 2006. Ky rrjet është një nismë e Fondacionit Soros (Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - OSFA) dhe synon të ndikojë formulimin e vizioneve strategjikë të zhvillimit të vendit, hartimin e politikave publike dhe mbështetjen e veprimeve qytetare për sendërtimin e tyre. Aktualisht projekti "Bashkëveprimi Ndërkunor në Qeverisjen Vendore dhe Zhvillimi Rajonal" është një projekt që Co-PLAN po e zbaton në kuadër të angazhimeve në rrjetin NOSA.

Të tetë organizatat pjesëmarrëse në këtë rrjet kanë marrë përsipër të angazhohen në fushat e qeverisjes së mirë, forcimit të shoqërisë civile dhe integrimit european të vendit. Anëtarët e tjerë të rrjetit NOSA janë:

Fondacioni Soros, AIIS, IPLS, Mjaft, ISB, Partners Albania, Qëndra Europiane

FINANCAT dhe TRANSPARENCA



Raport i auditorëve të pavarur
Për Drejtorin Ekzekutiv të Co-PLAN,
Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Tiranë, më 10 Prill 2007

Ne kemi audituar bilancin kontabël të Co-PLAN, Institut i per Zhvillimin e Habitatit (Organizata) deri më 31 Dhjetor 2006, bashkëngjitur këtij raporti, si dhe pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve dhe të fluksit të parave, që lidhen me këtë bilanc, për vitin ushtrimor që mbyll. Këto pasqyra financiare janë përgatitur nën përgjegjësinë e drejtimit të organizatës. Përgjegjësia jonë është të jepim mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Sipas këtyre standardeve ne jemi të detyruar të planifikojmë dhe ushtrojmë auditimin për të arritur një siguri të arsyeshme mbi faktin nëse këto pasqyra financiare nuk përbajnjë gabime ose shambahje materiale. Një auditim përfshin shqyrtim të evidencës që mbështet shumat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare, mbi bazë testimi. Një auditim përfshin gjithashtu edhe vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe gjykimeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi menaxherial. Ne besojmë që auditimi ynë siguron një bazë të shëndoshë për gjykimin tonë.

Sipas gjykimit tonë, pasqyrat financiare jepin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në tërësinë e materialit, të gjendjes financiare të Organizatës deri më 31 Dhjetor 2006, si dhe të rezultatit të veprimeve të saj e të fluksit të parave për vitin që mbyll. Në përputhje me metodën "kontabilizim fondesh", siç pershkruhet në shënimin 2.

Ky rapport lëshohet për informacion dhe përdorim vetëm për drejtimin e Organizatës dhe donatorët e saj. Rrjedhimisht, materiali nuk duhet përdorur për qëllime të tjera dhe për këtë arsy nuk duhet shpërndarë pa marrë pëlgimin tonë me shkrim.

KPMG Albania sh.p.k.
Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit
Tiranë-Shqipëri

Pasqyra e Konsoliduar e të Ardhurave dhe Shpenzimeve për vitin 2006 (në EUR)

	2006	2005
Të ardhurat		
Financuar nga donatorët	1,168,011	630,910
Totali i të ardhurave	1,168,011	630,910
Shpenzimet		
Shpenzime programi	(1,089,531)	(596,952)
Shpenzime administrative	(50,043)	(52,439)
Fonde nga donatorët alokuar te fondi rezervë	(40,728)	(5,818)
Totali i shpenzimeve	(1,180,302)	(655,209)
Deficiti i të ardhurave dhe shpenzimeve para të ardhurave të tjera	(12,290)	(24,300)
Të ardhura të tjera		
Të ardhura nga interesat	15,215	4,940
Shitja e aseteve fiksë	-	15,056
Fitim/(humbyje) nga kursi i këmbimit, neto	(20,101)	24,383
Të ardhura nga aktivitetë të tjera	21,825	30,570
Totali i të ardhurave të tjera	16,939	74,949
Suficit i të ardhurave mbi shpenzimet para alokimit të fondit rezervë	4,648	50,649
Alokuar te fondi rezervë	(4,648)	(50,649)
Rezultati i vitiit	--	--

Pasqyra e Konsoliduar e Bilancit në datën 31 Dhjetor 2006 (në EUR)

	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Asetet		
Arka dhe banka	480,553	938,895
Debitorë projekti	625,057	802,067
Debitorë të tjera	6,512	63,896
Asete fiksë, neto	163,961	196,888
Totali i aseteve	1,276,083	2,001,746
Detyrimet, fondet e projekteve dhe fonde të tjera		
Detyrimet	31,928	32,267
Fondet e projekteve	824,668	1,595,368
Fonde të tjera	419,487	374,111
Totali i detyrimeve	1,276,083	2,001,746

**PROJEKTET
dhe
ROGRAMMET**

**MENAXHIMI URBAN
DHE
RAJONAL**

TREHIMI 5

ENAXHIMI NJEDISOR
BASHKIAK

ZHVILLIMI ORGANIZATIV
INSITUTCIONAL

EMRI I PROJEKSTIT/PROGRAMIT	KOHË ZGJATJA	DONATORET	FONDET
Për një qeverisje të mirë urbane EGUG II	2003 – 2006	Ambasada e Mbretërisë së Vendevë të Ulta	1,152,552 Euro
Bashkëveprimi ndërkunor në qeverisjen vendore dhe zhvillimi rajonal	2006 – 2008	OSFA / NOSA	83,300 USD
Lehtësimi i partneriteteve	2004-2007	Cordaid	212,400 Euro
Drejt një shoqërie përfshirëse në Elbasan – Integrimi i grupeve në nevoje në zhvillimin urban	2006-2008	Cordaid	247,538 Euro
Hapa drejt rehabilitimit urban dhe integrimit të komunitetit të zonës informale të Kënetës, Durrës	2004 – 2007	ADA, Agjensia Austriake e Zhvillimit, Co-PLAN, Bashkia Durrës	351,748 Euro
Energitë e qëndrueshme për Shqipërinë	2006 –2007	Cordaid	199,577 Euro
Zhvillimi urban dhe rikualifikimi mijedisor në bashkinë Kamëz nëpërmjet bashkëpunimit publik-privat dhe pjesëmarrjes së shoqërisë civile	2004 – 2006	Bashkimi Europian (nënkontraktuar CISP)	322,820 Euro
NET Rrjeti për shkëmbim dhe trajnim	2004-2007	Cordaid	1,007,976 Euro
Inventarizimi i mekanizmave të përgjegjshmërisë sociale në Europë dhe Azinë Qëndore – Shqipëri, Bosnie-Herzegovinë, Maqedoni	2007	Banka Botërore	15,000 Euro

Për një Qeverisje të Mirë Urbane – EGU

PROGRAMIT	KOHÈZGIJATJA	DONATOR
Programe e reperitje të Mirë Urbane (EGUG II)	2003-2006	Ambasada Mbretëri Vendeve të ne Tura

e mirë me pjesëmarrje përbën themelin e filozofisë së punës të Co-PLAN, e një shoqërie demokratike urbane. Programi EGUG, i nisur më 2003 me ynoi pikërisht krijimin e modeleve të qeverisjes së mirë urbane me pjesëmarrje publik-privat dhe ngritur aftësitë organizative e profesionale të njësive vere, en me sukses të plotë të programit, pas një periudhe pune intensive trevjeçore bashkitë e përzgjedhura të Elbasanit dhe Fierit.

fundit tē tij, programi u përqëndrua kryesisht në asistencën teknike në këtë eave dhe përpjekjen e dijeve dhe tē përvojës së grumbulluar, duke përmirësuar tij. Në këtë pikëpamje, paketa e plotë e instrumentave për një qeverisje e finalizimin e Strategjisë të Zhvillimit dhe Planeve të Përgjithshme Rreth Elbasanit dhe Fierit.

ë e Zhvillimit për qytetet Elbasan dhe Fier janë hartuar me anë të një procesi i cili ishte çelësi i suksesit për pronësinë dhe legjitimitetin e tyre, duke i kthyer "të" të vërtetë për qytetet përkatëse. Tregues i mirëfilltë i suksesit është nipi i Bashkiak, të këtyre dokumentave themeltarë për mbarëvajtjen e qyteteve së ardhshme si një instrument ombrellë, në të njëjtën linjë me Strategjitet e hartuan nga Këshilli Lokal dhe Profilet e Mjedisit dhe të Kulturës, si dokumente të brendshme që punën e përditshme dhe përmes të cilave.



Planet e Përgjithshme Rregulluese të Elbasanit dhe Fierit janë hartuar, gjithashtu, në kuadër të projektit, pas hartimit dhe miratimit në nivel vendor e qëndor të Detyrës së Projektimit për secilin qytet. Mëse 40 takimet e koordinimit dhe vjeljes së mendimit me specialistë të administratës vendore apo të grupeve te interesit krijuan fryshtëzim mësim të nevojshme të bashkëpunimit përfshirë finalizimin e Planit Rregullues. Planet u hartuan në përpunim me dy OJF vendore, si dhe orientojnë zhvillimin urban të qyteteve përfshirë 20 vjetet e ardhshme. Duke tejkaluar objektivat e programit, Plani Rregullues përfshirë Fierin gjeti konsensusin në nivelin politik dhe u miratua nga KRT-ja e Fierit.



Përveç proceseve strategjike përfshirë qytetin, programi parashikonte edhe projekte konkrete pilot si përvijuese të zbatimit në terren të objektivave afatshkurtër të strategjive të hartuara të zhvillimit. Kjo e bëri më të plotë ciklin e asistencës ndaj pushtetit vendor përfshirë instrumentat e qeverisjes së mirë me pjesëmarrje. Këto projekte u kryen në partneritet të plotë me bashkitë e Elbasanit dhe Fierit, të cilat financuan 50% të fondeve. Projektit u vijnë në jetë sipas përparrësive të përcaktuara nga bashkitë. Si rezultat, u krijuan 12 lulishte në lagjet e qyteteve, u rehabilituan dhe u pajisën me ndriçim rrugor disa akse kryesore rrugësh në Elbasan dhe Fier.



Një komponent tjetër i rëndësishëm që iu bashkëngjitet programit ishte edhe procesi i buxhetimit me pjesëmarrje në Elbasan. Ky proces i shërbue bashkisë si një instrument i domosdoshëm financiar përfshirë vënien në jetë të strategjisë, duke caktuar fondet e posaçme në buxhetin bashkiak përfshirë 2007 sipas përparrësive të qytetarëve në dispozicion të projekteve. Bashkia udhëhoqi procesin që përfshirë mëse 550 qytetarë, në bashkëpunim me dy OJF vendore. Komisioni i ngritur me përbërje përfaqësues nga qytetarët, këshilltarë bashkiakë e punonjës të bashkisë, përzgjodhi përparrësitet përfshirë ndërhyrje në bazë të kriterieve të mirëpërcaktuara dhe vizitave verifikuese në terren.

Përhapja e dijeve dhe përvjelles së fituar nga ky projekt ishte fjala kyçe përfshirë përmbylljen e programit gjatë 2006. Aktivitetet e zhvilluar në këtë drejtim kulmuan me Seminarin Rajonal mbi Praktikat e Qeverisjes së Mirë me Pjesëmarrje dhe me Forumin Kombëtar Urban të kryera në tremujorin e fundit të vitit. Këto aktivitete u shoqëruan edhe me prezantimin e një sërë materialesh të publikuara, si botimet e Strategjisë së Zhvillimit të qyteteve Fier e Elbasan, të CD-toolk interaktive, dokumentarit televiziv mbi programin, etj.






Projekti: Bashkëveprimi ndërkunor në qeverisjen vendore dhe zhvillimi rajonal

EMRI I PROJEKTIT	KOHËZGIJATJA	DONATORËT	FONDET
Bashkëveprimi ndërkunor në qeverisjen vendore dhe zhvillimi rajonal	2006-2008	OSFA/SOROS	83.300 USD

Procesi i decentralizimit nuk është një qëllim në vetvete, por një rrugë për të siguruar cilësi me të lartë të shërbimeve publike për qytetarët. Riformat e decentralizimit në Shqipëri kanë nxjerrë në pah domosdoshmérinë e koordinimit ndërmjet niveleve dhe strukturave të ndryshme të pushtetit vendor, sidomos në sigurimin e shërbimeve publike. Projekti "Bashkëveprimi ndërkunor në qeverisjen vendore dhe zhvillimi rajonal" kontribuon pikërisht në këtë drejtim. Qëllimi i tij është eksplorimi dhe nxitja e bashkëpunimit ndërmjet njësive vendore për të ofruar shërbime sa më cilësore për qytetarët.

Projekti është ndërmarrë në kuadër të rrjetit NOSA (Rrjeti i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë) dhe financohet nga Fondacioni Soros. Ky projekt trevjeçar, gjatë vitit 2006 u fokusua mbi studimin e shërbimit të transportit publik në rajonin e Tiranës, duke bërë një vlerësim praktik të ecurisë së decentralizimit për këtë shërbim. Risia që solli në fushën e qeverisjes vendore konsiston në faktin që shërbimi i transportit publik, si ndër të parët e decentralizuar, u analizua nën optikën e bashkëpunimit midis njësive vendore për ofrimin e një cilësie më të mirë për përdoruesit.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2006 projekti organizoi një mori diskutimesh, pyetësorësh dhe intervistash me qytetarë, përdorues, apo operatorë privatë dhe biznese, si dhe tryesa të rrumbullakëta, konsultime me aktorë qëndrorë dhe vendorë, me organizata ndërkombëtare zhvillimi, etj. Studimi mbi transportin publik u fokusua mbi rajonin e Tiranës, duke përfshirë tre bashki dhe 13 komuna. I kryer në disa fazë, studimi nxori në pah mjaft gjetje dhe rezultate interesante mbi situatën e transportit publik. Ky studim, që iu prezantua dhe shpërndaja një sërë institucionesh vendore dhe qendrore, paraqiti disa konkluzione dhe alternativa të mundshme përmirësimin dhe integrimin e këtij shërbimi publik, duke u mbështetur në potencialet e bashkëveprimit ndërkunor, apo duke krijuar forma të reja menaxhimi dhe planifikimi si Autoriteti Metropolitan, shoqëri aksionere, etj. Konkluzionet e studimit rreken të jepin orientime që i shkojnë përshtat vizionit për një zhvillim të integruar të shërbimeve publike në nivel rajonal.





Programi: Lehtësimi i partneriteteve


EMRI I PROJEKTIT	KOHEZGJATJA	DONATORËT	FONDET
Lehtësimi i Partneriteteve	2005-2007	Cordaid	212,400 Euro

Një nga vlerat më të spikatura të organizatës është partneriteti dhe bashkëpunimi për nismat e ndërmarrja. Në këtë fryshtë konceptuar ky program i financuar nga organizata hollandeze Cordaid, synimi i të cilit është lehtësimi i partneriteteve me institucionet, komunitetet, dhe sektorin privat. Programi i nisur në 2004 është orientuar në projekte të konceptuara në funksion të misionit dhe objektivave të organizatës. Gjatë vitit 2006 programi është shtrirë në rrafshin e nxitjes së praktikave të qeverisjes së mirë, forcimit organizativ të organizatës dhe lidershipit institucional.

Në vijim të shtrirjes së modelit të planifikimit me pjesëmarrje, si një nga instrumentat e qeverisjes së mirë, gjatë vitit 2006 ka vazhduar asistencë ndaj bashkisë Berat. Qëllimi i projektit është hartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Beratit. Si hap i parë në këtë drejtim ka qenë mbledhja e të dhënave mbi qytetin. Në këtë kuadër është kryer studimi social-ekonomik për qytetin, i bazuar në 800 pyetësorë me qytetarët e Beratit. Përveç kësaj, është krijuar një -azë të dhënash dhe ka përfunduar analiza institucionale në bashki. Mbi këtë bazë është përpiluar një dokument paraprak i Detyrës së Projektimit. Përveç asistencës teknike, projekti ka konsistuar edhe në ngritjen e aftësive organizative e profesionale të punonjësve bashkiakë me anë të trajnimeve të dhëna. Prosesi i zhvilluar është kryer dora-dorës me përshtirjen e grupeve të interesit nëpërmjet organizimit dhe mbledhjes së grupeve tematike, të takimeve me aktorë të shoqërisë civile, biznesit apo ekspertëve.

Rinovimi i kërkimit shkencor në lidhje me zhvillimet urbane të vendit është konsideruar një element i rëndësishëm për të krijuar partneritetet brenda kuadrit të programit. Për të kontribuar në këtë drejtim, Co-PLAN iu bashkua nismës së Institutit të Kulturës Popullore për organizimin e Shkollës Verore mbi Antropologjinë Urbane në shtator të 2006, duke mundësuar ardhjen e dy lektoreve të shquar nga Italia. Në këtë aktivitet 2 javor morën pjesë mës 19 pjesëmarrës të nivelit master dhe doktoraturë nga Shqipëria dhe Kosova, si edhe lektore shqiptarë e të huaj nga institucione kërkimore prestigjoze në fushën e antropologjisë. Aktiviteti pati mjaft vlerë, pasi për herë të parë studiuves antropologë të vjetër e të rinj, nga Shqipëria e Kosova, të huaj e shqiptarë, u ulën në një tryezë të rrumbullakët për të diskutuar dhe vlerësuar gjendjen aktuale të kërkimit të antropologjisë urbane në Shqipëri dhe ngritën teza për të ardhmen e këtij kërkimi.





**Projekti: Drejt një shoqërie përfshirëse në Elbasan –
Integrimi i grupeve në nevojë në zhvillimin urban**

EMRI I PROJEKTIT	KOHËZGJATJA	DONATORËT	FONDET
Drejt një shoqërie përfshirëse në Elbasan – Integrimi i grupeve në nevojë në zhvillimin urban	2006-2008	Cordaid	247,538 Euro

Komuniteti rom, që përballet me probleme të varférisë së tejskajshme, përashtimit dhe diskriminimit social, ka tërhequr vëmendjen e mjaft institucioneve në vendin tonë. Projekti "Drejt një shoqërie përfshirëse në Elbasan – Integrimi i grupeve në nevojë në zhvillimin urban" kërkon të orientojë pikërisht integrimin social, politik dhe ekonomik të afro 3,000 pjesëtarëve të një komuniteti kryesisht romësh, që jetojnë në një zonë informale 5 km në periferi të qytetit të Elbasanit. Ky projekt financohet nga organizata hollandeze Cordaid dhe ka filluar të zbatohet në dhjetor të vitit 2006 në partneritet me bashkinë e Elbasanit dhe Qëndrën Sociale Balashe.

Qëllimi i këtij projekti është të kontribuojë në rritjen e standardit të jetesës së këtij komuniteti në nevojë, drejt integrimit urban të tyre nëpërmjet një sërë aktivitetesh për të ndryshuar pozitivisht statusin e komunitetit rom në qytetin e Elbasanit.

Projekti lindi si një nevojë e natyrshme e artikular e autoriteteve vendore për të adresuar çështjen e zhvillimit urban të një zone informale të banuar kryesisht nga komuniteti rom, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të qytetit. Kjo nevojë gjeti mbështetje tek përvaja e pasur e Co-PLAN me projektet me pjesëmarrje për zhvillimin e komunitetit, nëpërmjet qasjes së planifikimit urban. Projekti ka ndërmarrë këto objektiva kryesore:

1. Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit rom në proceset vendimmarrëse në Elbasan;
2. Rritje aftësisë organizative të organizatave rime komunitare,
3. Përmirësimi i standardeve të infrastrukturës fizike në zonat ku jetojnë romët,
4. Rritja e aftësisë së autoriteteve vendore për t'u përballur me problemet e komunitetit rom dhe për të krijuar ura bashkëpunimi me këtë komunitet;
5. Hartimi i një programi për zhvillimin e lagjes për komunitetin rom nëpërmjet një procesi pjesëmarrës nga bashkia Elbasan.

Projekti përpushtet dhe është në të njëjtën linjë me Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom, e cila parashikon adresimin e disa nevojave parësore të komunitetit rom brenda 15 vitesh. Gjithashtu, projekti është plotësish i integruar në Strategjinë e Zhvillimit të Elbasanit, të hartuar me asistencën e programit EGUG II nga Co-PLAN.





**Projekti: Hapa drejt Rehabilitimit Urban dhe Integrimit të Komunitetit
të Zonës me Zhvillim Informal Kënetë, Durrës**

EMRI I PROJEKTIT	PERIUDHA	DONATORËT	FONDET
Hapa drejt Rehabilitimit Urban dhe Integrimit të Komunitetit të Zonës me Zhvillim Informal Kënetë, Durrës	2004-2007	ADA - Agjensia Austriake e Zhvillimit Cordaid Co-PLAN Bashkia Durrës	351,748 Euro

Qytetarët që jetojnë në zonat informale ende nuk konsiderohen si pjesë integrale e qyteteve tona. Ky projekt krijon pikërisht një perspektivë për integrimin social dhe urban të banorëve të një zone pilot prej 50 ha në Kënetë, Durrës, duke lehtësuar komunikimin dhe bashkëpunimin e tyre me bashkinë Durrës për urbanizimin e zonës. Projekti i financuar nga Qeveria Austriake, nëpërmjet Agjencisë Austriake të Zhvillimit ADA, ka nisur të zbatohet që në vitin 2004. Edhe gjatë vitit 2006 projekti është përqënduar në 3 procese kryesore: legalizimi, ndërrhyra në infrastrukturë dhe proceset pjesëmarrëse me banorët dhe bashkinë.

Në lidhje me procesin e legalizimit të zonës, gjatë vitit 2006 projekti ka përvjuar me asistencën e dhënë kryesisht në nivel vendor ndaj zyrës lokale të ALUIZNI-t dhe banorëve të zonës. Stafi vendor i ALUIZNI -t u trajnua për ndjekjen e kësaj metodologji: krijimin e bazës së të dhënave mbi legalizimin, përdorimin e informacionit, krijimin e hartave tematike, studimet urbane pjesore, etj. Duke qenë se gjatë vitit 2005 u ndoq një metodologji e suksesshme për legalizimin, zona u mor si shembull pilot nga ALUIZNI në nivel qëndor për të ndjekur të njëjtat hapa në të gjithë vendin. Për më tepër, projekti dha asistencë në përgatitjen e ligjit të ri të legalizimeve, për përgatitjen e udhëzimeve bashkëngjitur ligjit, si edhe të manualeve për aplikimin e tij.



Projekti: Energji të Qëndrueshme për Shqipërinë

EMRI I PROJEKTIT	KOHËZGJATJA	DONATORËT	FONDET
Energjitet e Qëndrueshme për Shqipërinë	2006-2007	Cordaid	199.577 Euro



Paralelisht me përpjekjet për legalizimin e ndërtimeve pa leje, ka ecur edhe procesi për planin urban të zonës dhe ndërhyrjet në infrastrukturë. Teksa Plani Urbanistik Pjesor i zonës është miratuar tashmë nga KRRT-ja e Qarkut Durrës, gjatë vitit 2006 u përgatitën edhe projektet teknike përmirësimet në infrastrukturë në bashkëpunim me punonjësit e bashkisë Durrës. Në vijim, pati interes nga disa institucionë qëndrore si Ministria e Arsimit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, etj, për të kryer investime në infrastrukturën sociale dhe fizike të zonës. Kjo, si pasojë e faktit që zona është tashmë e pajisur me një studim urban pjesor të miratuar dhe të plotësuar me studimet përkatëse për infrastrukturën, si dhe me një bazë të dhënat të saktë mbi territorin. Në këtë këndvështrim, projekti ka luajtur një rol kyç për të kryer koordinimin mes institucioneve vendore apo qëndore. Për vitin 2007 janë planifikuar të kryhen ndërhyrje në infrastrukturë me fonde të projektit, sipas përparrësive të përcaktuara nga komuniteti.



Fuqizimi i mëtejshëm i komunitetit ka përvjuar edhe gjatë vitit 2006. Vlen të përmendet formimi i shoqatës komunitare "Bashkë për Integrin dhe Zhvillim" dhe i grupit të konsoliduar të të rinjve, të cilët u trajnuan e më pas u asistuan për përgatitjen e platformës së integrimit të zonës dhe të të rinjve të Kënetës. Më tej, këto platforma u janë paraqitur edhe kandidatëve për kryetar bashkie për Durrësin për t'i marrë parasysh në programet e tyre elektorale. Platformat e përpiluara nga këto struktura komunitare bazohen mbi vizionin dhe përparrësitet e përcaktuara nga vetë komuniteti për zhvillimin e zonës, përmes procesit të krijimit të Programit të Zhvillimit të zonës.

